



GLOBAL CONSULTING
Blv "Zog I", P.64, Nr. 1/5, Tiranë

CEL: 066 60 77 788
E-mail: dn.albania@gmail.com

AKT THEMELIMI

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"D.N. GLOBAL CONSULTING" Sh.p.k.

Në bazë të Ligjeve në Republikën e Shqipërisë :

- Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare".
- Ligji i "Q.K.R".

Me vullnetin tim të lirë deklaroj se sot, më datë 01.07.2015 kam përpiluar si më poshtë vijon Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, të emërtuar "D.N. GLOBAL CONSULTING" Shpk.

Themeluesi dhe ortaku i vetëm:

Dorian NANO, i biri i Bedriut dhe i Donikës, me kombësi e shtetësi shqiptare, lindur më 07.01.1981 në Tiranë dhe me banim: Blv Zog I, P.64, Shk 1, Apt 5, Tiranë, identifikuar nëpërmjet dokumentit Kartë Identiteti Nr.030768196, datë 22.02.2011, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.



GLOBAL CONSULTING
Blv "Zog I", P.64, Nr. 1/5, Tiranë

CEL: 066 60 77 788
E-mail: dn.albania@gmail.com

NENI 1 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar emërtuar "D.N. GLOBAL CONSULTING" Shpk ka për objekt të veprimtarisë së saj:

2.1. Ofrimin e shërbimeve të përkthimit të materialeve e dokumentave të ndryshme në gjuhë të huaja dhe shqip; ofrimi i shërbimeve të konsulencës për persona fizikë e juridikë vendas dhe të huaj si përgatitje dokumentacioni apo dokumentash të ndryshme sipas nevojave të klientëve, depozitim apo tërheqje dokumentash a lejesh të ndryshme pranë institucioneve shtetërore e private, përgatitje projektesh, studimesh, relacionesh, plan biznesesh, studime tregu e studime të ndryshme me karakter informues për klientët apo partnerët e Shoqërisë në të gjitha fushat, konsulencë strategjike, marketingu, financiare dhe kontabël, si dhe aktivitetet e ndërmjetësimit konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2.2. Ofrimin e shërbimeve në sektorin Pest Control: dezinfektimit, dezinfektimit, deratizimit (DDD), pastrimit dhe kujdesit për parqet publike. Gjithashtu Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e konsulencës në sektorët e sipërpërmendur duke iu referuar veçanërisht normativave në fuqi, por edhe konsulencën në fushën e ushqimeve dhe pijeve. Shoqëria, për aktivitetin që do të ushtrojë, do të përdorë dhe emërtimin: "Pest Control" në logon e saj në rastin e shërbimeve të dezinfektimit, por çdo kontratë do të lidhet me emrin "D.N. GLOBAL CONSULTING Shpk".

2.3. Tregti produktesh për publicitet, agjensi publicitare, marrdhënie publike, krijim, programim, organizim dhe përgatitje eventesh të ndryshme, shërbim hostess, shërbime kryesore për realizimin e eventeve të ndryshme.

2.4. Tregti me shumicë e pakicë të ushqimeve për kafshët, artikuj dhe pajisje sportive, artikuj kampingu, por edhe artikuj veshmbathjeje me konfeksione të çdo lloji dhe vlere, përfshirë trikotazhet e jashtme dhe këmbë, aksesorë veshjesh të çdo lloji dhe vlere, përjashtimisht sendet e vlefshme; veshmbathje intime të çdo lloji dhe vlere; këpucë dhe artikuj lëkure të çdo lloji dhe vlere; tregti me shumicë e pakicë të artikujve për higjienën dhe pastërtinë e biznesit, shtëpisë dhe atë personale, biocidet dhe produktet për përdorim në higjienën publike, prodhime bujqësore; prodhime kimike bujqësore, prodhime kimike të përgjithshme, detergjentë, aksesorë, makineri, pajisje dhe artikuj teknikë bujqësorë, industrialë, komercialë dhe artizanalë, importin dhe eksportin e tyre.

2.5. Shoqëria mund të kryejë në Shqipëri dhe jashtë shtetit të gjitha operacionet (veprimet) komerciale, industriale dhe financiare, të tundshme dhe të patundshme të shoqërive të tjera



apo kompanive me objekt veprimtarie analog administrativ për arritjen e objektivit të Shoqërisë, mund të marrë përsipër dhe të japë delegime dhe pjesëmarrje të një domosdoshmërie e rëndësie të veçantë nga organi administrativ për arritjen e objektivit të Shoqërisë në shoqëri të tjera apo kompani me objekt veprimtarie analog, të lidhur me të në mënyrë direkte apo indirekte.

2.6. Furnizime ushqimore dhe pije të ndryshme, konfeksione veshmbathje, patentash e liçencash, organizim për llogari të vet apo për palë, konsulencë, regjistrim, tutelë dhe shfrytëzim markash të treta.

2.7. Import, eksport mallrash dhe pajisjesh elektrike dhe elektronike të të gjitha llojeve, makinerish dhe pajisjesh, mjete transporti, etj, si dhe aktivitetin e shpërndarjes dhe përdorimit të këtyre shërbimeve të ndryshme në favor të të tretëve, operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndërtime objektesh industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndërtime, financime, të luajtshme e të paluajtshme e financime të ndryshme që Administratori i quan të nevojshme për arritjen e qëllimit dhe objektivit të Shoqërisë, si dhe çdo objekt tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

2.8. Krijimin, administrimin dhe përhapjen e bazave të të dhënave në sisteme të kompiuterizuara të administruara nga Shoqëria, tregti programesh kompiuterike, software, hardware, shërbime elektronike, pjesë këmbimi, etj.

2.9. Krijimin, çeljen dhe administrimin e call center për ofrimin e shërbimit ndaj klientit për të gjitha llojet e shërbimeve të mundshme në të gjithë sektorët e fushat ku mund të operohet, shitje produktesh, kontratash e shërbimesh të ndryshme për llogari të Shoqërisë apo të të tretëve me telefon, online, apo me çdo mënyrë tjetër kontakti të parashikuar.

Shoqëria për ofrimin e shërbimeve të sipër përmendura, në bazë të normativave në fuqi, mund të shfrytëzojë edhe palë të treta.

Gjithashtu Shoqëria, në lidhje me sektorët e sipër përmendur, mund të kryejë aktivitete ndërmjetësie dhe të marrë mandate nga agjensitë dhe / apo përfaqësitë me apo pa depozitë.

Në objektin e veprimtarisë përfshihet pjesëmarrja në shoqëri të çdo lloji, partneritete, ente, shoqata dhe subjekte të çfarëdolloj natyre me objektiv të ngjashëm apo analog me atë të Shoqërisë.



GLOBAL CONSULTING
Blv "Zog I", P.64, Nr. 1/5, Tiranë

CEL: 066 60 77 788
E-mail: dn.albania@gmail.com

NENI 2 SELIA

Selia e Shoqërisë është vendosur në: **Bulevardi "Zog I", Pallati 64, Nr. 1/5, Tiranë.**
Këshilli Administrativ mund të krijojë, modifikojë apo anulojë seli sekondare, agjensi dhe përfaqësi kudo që e quan të nevojshme, madje edhe jashtë shtetit.
Qendra fiskale e ortakëve, përsa u përket raporteve të tyre me Shoqërinë, është selia e Shoqërisë.
Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: **dn.albania@gmail.com**

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pa përcaktuar dhe mund të zgjidhet përpara kohe me miratim të Asamblesë së Jashtëzakonshme.
Shoqëria e fillon aktivitetin në momentin e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

NENI 4 KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

Kapitali Themeltar është 100.000 (Njëqindmijë) Lekë dhe është ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë 100.000 (Njëqindmijë) Lekë, me numër serie 1 (Një).
Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
Themeluesi dhe ortaku i vetëm Dorian NANO: zotërues i 1 (një) kuote që përbën 100% (njëqind për qind) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
Të ardhurat neto të Shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm.

NENI 5 DREJTIMI I SHOQËRISË, ORGANET

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, ortaku i vetëm dhe përfaqësuesi ligjor i saj.



GLOBAL CONSULTING
Blv "Zog I", P.64, Nr. 1/5, Tiranë

CEL: 066 60 77 788
E-mail: dn.albania@gmail.com

Organet e Shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori/ët.

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë i Shoqërisë dhe i vetmi organ vendimmarrës. Asambleja e Ortakëve miraton çdo ndryshim të statutit sipas mënyrave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Ortakëve caktoi Administrator të Shoqërisë personin e mëposhtëm me mandat 5 (pesë) vjeçar:

Të dhënat e identifikimit:
(emri, rimbimri, adresa):

Dorian NANO
Blv Zog I, P.64, Shk 1, Apt 5, Tiranë

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Ortaku i vetëm themelues ka të drejtë të emërojë edhe administratorë të tjerë të vlerave materiale.

Ka të drejtë të caktojë financiarë, likuidatorë për problemet e Shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

NENI 6 TË ARDHURAT

Të ardhurat neto të Shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm.

NENI 7 VULA

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin e përmbajtur në të.



GLOBAL CONSULTING
Blv "Zog I", P.64, Nr. 1/5, Tiranë

CEL: 066 60 77 788
E-mail: dn.albania@gmail.com

NENI 8 BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi, me statutin e saj dhe dispozitat e legjislationit shqiptar. Detajet dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë janë paraqitur në statutin e Shoqërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi dhe në statutin e Shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9 MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij akti themelimi, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

NENI 10 HARTIMI I AKTIT TË THEMELIMIT

Ky Akt Themelimi u hartua sot më dt. 01.07.2015 në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe për t'iu shpërndarë organeve kompetente dhe 1 (një) kopje do të ruhet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë "D.N. GLOBAL CONSULTING" Shpk.

ORTAKU DHE THEMELUESI I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "D.N. GLOBAL CONSULTING"

Dorian NANO
(emër mbiemër)

(nënshkrimi)